

AKT-THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"INDEX GLOBAL" shpk

Sot, më datë 18.09.2024 hartohet Akti i Themelimit i Shoqërisë

"INDEX GLOBAL" shpk

Me anë të këtij dokumenti, të hartuar në 4 (katër) kopje origjinale, ortakët e shoqërisë:

Z. Gerhard Canellari i datëlindjes 02/01/1992 shtetas Shqiptar, lindur dhe banues në Tiranë mbajtës i letërnjoftimit nr ID personale J20102051V.

Z. Mehmet Baburhan Batu i datëlindjes 17/04/1986 shtetas Turk, lindur dhe banues në Turqi mbajtës i letërnjoftimit nr ID personale 41231015388.

deklarojmë se aktiviteti i shoqërisë **"INDEX GLOBAL" shpk**, do të rregullohet, organizohet dhe zhvillohet në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

1) **Ky Akt-Themelimi dhe Statuti** bashkalidhur, janë përgatitur në bazë të kërkesave të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

2) **Kohëzgjatja e aktivitetit** fiksohet për një periudhë kohe të pakufizuar.



1



3) Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

Rregullimi i transportit si agjent spedicioni për të gjitha llojet e ngarkesave me det, tokë, ajër, të veprojë si agjent transporti nderkombëtar, ngarkesa konteinerësh dhe transport ndërkombëtar i tyre, siguracione dhe doganë duke kryer të gjitha shërbimet e nevojshme që lidhen me to si dhe kryerjen e transporteve brenda dhe jashtë vendit, për interesat e veta e të tretëve. Kryerjen e çdo aktiviteti tregtar, financiar, dhënie, marrje me qira, dhënie makinash me qira, tregti me shumicë e pakicë mallrash të ndryshëm, tregti makinash, pjesë këmbimi për autovetura, të kryeje aktivitete publikimi dhe reklamimi, import dhe eksport i lëndeve të para, materialeve të ndërtimit, makineri për proçeset e prodhimit si dhe çdo aktivitet tjetër të lejuar nga ligji.

- 4) **Për përmbushjen e objektit të veprimtarisë**, shoqëria mund të marrë pjesë në bashkëpunim me shoqëri të tjera që kanë objekt të njëjtte ose te përafërt me të sajën dhe mund të kryejë direkt apo indirekt të gjitha operacionet e nevojshme për realizimin e objektit të saj.

Shoqëria mund të hapë dhe të mbajë llogari rrjedhëse në lekë apo valuta të tjera, pranë bankave shqiptare apo të huaja, duke mundur gjithashtu të disponojë lirisht mjetet monetare të akumuluar në to, në bazë të legjislatcionit në fuqi.

- 5) **Selia e shoqërisë** është në adresën "Rr Sami Frashëri, Pall. Bodrum nr. 3/C3, Tiranë". Asambleja si dhe organet e administrimit, kanë kompetencë të hapin filiale e agjensi të tjera dhe t'i mbyllin, sipas çmuarjes dhe gjykimit, që ato i bëjnë cdo rasti.

6) Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet vetëm nga kontribute në para dhe është 20.000 lekë. Ky kapital është i ndarë në 2 kuota (dy) kuota me vlerë nominale respektive 10.000 lekë dhe 10.000 lekë.

Kuota në përqindje e ortakëve në kapitalin themeltar të shoqërisë është si më poshtë:

-Z. Gerhard Canellari, zotëron 1 kuotë, 50% të kapitalit themeltar me vlerë 10.000 lekë.

-Z. Mehmet Baburhan Batu, zotëron 1 kuotë, 50% të kapitalit themeltar me vlerë 10.000 lekë.

7) **Administratorët e shoqërisë**, emërohet për një periudhë kohe 5 (pesë) vjecare me të drejtë riemërimi janë:

Z. Gerhard Canellari, mbajtës i letërnjoftimit nr. J20102051V, i cili ka të drejtën e firmës dhe të përfaqësimit të shoqërisë.

Z. Mehmet Baburhan Batu, mbajtës i letërnjoftimit nr ID personale 41231015388, i cili ka të drejtën e firmës dhe të përfaqësimit të shoqërisë.

Administratorët gëzojnë kompetenca të pakufizuara për realizimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që janë ngarkuar asamblesë së përgjithshme.

Në përmbushje të detyrës së tyre mund të venë në lëvizje instanca juridike dhe administrative, duke emëruar avokatë e duke lëshuar prokura në raste gjyqesh, të kryejnë operacione bankare, përfshirë këtu edhe hapjen e llogarive rrjedhëse, nënshkrimin dhe xhirimin e çeqeve, realizimin e terheqjeve dhe derdhjeve me lekë ne dorë apo urdhër-xhirimi, tituj krediti, paradhënie krediti.

Administratorët në përfundim të cdo viti ekonomik përpilojnë një relacion mbi aktivitetin e zhvilluar, objektivat e arritura dhe perspektivën e shoqërisë, si dhe përgatisin bilancin përfundimtar që ia paraqesin cdo vit Asamblesë për aprovim.

8) **Viti ekonomik** fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të cdo viti.

9) **Vlera e kontributit dhe kuotat e ortakëve** shënohen në një libër të posacëm të shoqërisë.

Në përfundim të vitit ekonomik, pas aprovimit të bilancit, Asambleja pasi ka ndarë fondet për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve, detyrimet fiskale ndaj shtetit, rezervat e detyrueshme, vendos për ndarjen e fitimit neto. Për humbjet përgjigjet eskuzivisht shoqëria me kapitalin e saj.

10) **Ortakët** mund ta zmadhojnë kontributin e tyre dhe si pasojë edhe kuotën e tyre, duke depozituar fitimet e realizuara nga aktiviteti i shoqërisë, konform asaj së parashikuar në Statutin e shoqërisë.

11) **Ortakët dhe Administratorët** janë të detyruar të ruajnë sekretin mbi dokumentacionin dhe të dhënat, njohuritë dhe eksperiencat e fituara gjatë aktivitetit të shoqërisë, dhe marrin të gjitha masat e nevojshme të sigurisë për të evituar përhapjen, qoftë edhe pjesërisht.

Ata janë përgjegjës për pasojat negative që mund të vijnë nga shkelja e dispozitës së mësipërme. Për sa cituar më lart vlen edhe për Ekspertin Kontabël të Regjistruar.

Ortakët janë përgjegjës, ndaj të tretëve për dëmet që mund t'u shkaktohen nga anulimi apo deklarimi i pavlefshëm i këtij akti themelues.


Për sa nuk specifikohet shprehimisht në këtë akt, vlejné normat e Statutit bashkangjitur.

Njëkohësisht me nënshkrimin e këtij Akti, ortakët nënshkruajnë edhe Statutin e shoqërisë "**INDEX GLOBAL" shpk,** i cili i bashkalidhet aktit të themelimit dhe është pjesë përbërëse e tij.

ORTAKËT E SHOQËRISË

"INDEX GLOBAL" shpk

Gerhard Canellari

Gerhard Canellari


Mehmet Baburhan Batu

Mehmet Baburhan Batu
